



EUROPEAN UNION

**Office of The Auditor General
Zyra e Revizionit Gjeneral
Kancelarija Generalnog Revizora**

UNMIK



Dokument Nr. 20.2.1-2006-08

**RAPORTI I AUDITIMIT MBI PASQYRAT FINANCIARE TË ZYRËS
SË KRYEMINISTRIS PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31
DHJETORË 2006**

Prishtinë, Maj 2007

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME	3
1. HYRJE	4
1.1 KORNIZA E AUDITIMIT	4
1.2 FUSHËVEPRIMI I AUDITIMIT	5
1.3 STANDARDET NDËRKOMBËTARE TË AUDITIMIT (SNA)	5
1.4 ÇËSHTJET QË NDIKOJNË NË DHËNIEN E OPINIONIT	5
1.5 OPINIONI AUDITIMIT	5
1.6. STRUKTURA E KËTJ RAPORTI	6
2. RAPORTIMI I TË DHËNAVE FINANCIARE	6
2.1. PASQYRAT FINANCIARE	6
2.2. SISTEMI I KONTROLLIT TË BRENDSHËM	7
3. TË HYRAT	8
4. SHPENZIMET	8
4.1. PAGAT DHE MËDITJET	8
4.1.1. <i>Lista e pagave</i>	8
4.1.2. <i>Dosja e personelit</i>	9
4.2. SUBVENCIONET DHE TRANSFERET	10
4.3. MALLRAT DHE SHËRBIMET DHE SHPENZIMET KAPITALE	10
4.3.1. <i>Zotimi i mjeteve</i>	10
4.3.2. <i>Planifikimi i prokurimit</i>	11
4.3.3. <i>Çështjet e ndërlidhura me dokumentet e ofertimit dhe çmimeve të ofruara</i>	12
4.3.4. <i>Raportet për pranimin e mallrave dhe shërbimeve</i>	12
4.3.5. <i>Shpenzimet për riparimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve</i>	13
4.3.6. <i>Furnizim me pajisje të TI</i>	13
4.3.7. <i>Organizimi i workshop-ve</i>	14
4.3.8. <i>Furnizim me orendi për zyre</i>	15
4.3.9 <i>Harmonizimi i shpenzimeve</i>	15
5. MENAXHIMI I ASETEVE	16
5.1. REGJISTRIMI I ASETEVE DHE INVENTARIZIMI	16
5.2. SHFRYTËZIMI I AUTOMJETEVE	17
5.3. MIRËMBAJTJA E AUTOMJETEVE	18
KOMENTET NGA ZYRA E KRYEMINISTRISË	20

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

Auditimi në Zyrën e Kryeministrit është bërë nga Zyra e Revizionit Gjeneral (ZRGJ) për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2006. Qëllimi primar i Zyrës së Kryeministrit është të menaxhoj dhe koordinoj aktivitetet dhe projektet e ngritura nga Qeveria dhe Institucionet e tjera të Kosovës. Zyra e Kryeministrit të Kosovës si organi më i lartë i Qeverisë së Kosovës funksionon përmes njësisë të cilat mundësojnë dhe lehtësojnë punën e ekzekutivit të Kosovës.

Objektivë primare e këtij auditimi është që t'i mundësohet ZAGJ-së që ta japë opinionin nëse Pasqyrat Financiare të Zyrës së Kryeministrit japin një pasqyrë të vërtetë dhe të drejtë për të hyrat e arkëtuara dhe shpenzimet e kryera gjatë vitit i cili ka përfunduar më 31 dhjetor 2006, si dhe nëse keto pasqyra janë përgatitur në pajtim me Standardet ndërkombëtare të kontabilitetit të sektorit publik (SNKSP) lidhur me "raportimin financiar sipas kontabilitetit të parasë së gatshme".

Gjatë auditimit ZRGJ ka qenë e kënaqur që ka vërejtur përmirësime në zhvillimin e kontrollit të brendshëm krahasuar me vitin e kaluar. Megjithatë kontrolli i brendshëm në këtë institucion ende reflekton dobësi përmbajtjesore, mungesë të kontrollit në prokurime publike, nivel të lartë të mbi-pagesave dhe jo përputhshmëri në mes dosjeve të personelit dha pagave e mëditjeve. Jemi të shqetësuar edhe për menaxhimin e pasurisë dhe nivelin e kontrollit të stokeve që tregojnë se menaxhmenti nuk kujdeset në mënyrën e duhur për pasuritë e Zyrës. Por ne vërejtëm se që nga Janari i vitit 2007 është bërë angazhimi i një auditori të brendshëm në kuadër të ZKM që rrite mundësitë e përmirësimeve të mëturshme.

Megjithatë ne nuk kemi qenë gjendje të krijojmë siguri të mjaftueshme se Pasqyrat Financiare të Zyrës së Kryeministrit të prezantuara për vitin 2006, e prezantojnë drejtë dhe saktë gjendjen reale .

Për më tepër arsyt e cekur në seksionin 1.4 të këtij raporti.

1. Hyrje

Me 4 tetor 2002, Përfaqësuesi Special i Sekretariatit të Përgjithshëm (PSSP), miratoi rregulloren e UNMIK-ut 2002/18 – Për Themelimin e Zyrës së Revizionit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Revizionit të Kosovës, e cila në bazë të paragrafit 3.2 i jep kompetencat dhe përgjegjësit Revizorit të Përgjithshëm që të kontrolloj çdo vit Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës (BKK), në të gjitha Institucionet të cilat marrin mjete financiare nga BKK.

Ky Raport përmban te gjeturat , ndikimin dhe rekomandimet e auditimit te Zyrës se Kryeministrit për vitin 2006 ne kuadër te Auditimit te Pasqyrave Financiare te BKK-se për vitin 2006.

1.1 Korniza e auditimit

Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2002/18 më datë 04 tetor 2002, krijon bazën ligjore të Zyrës së Auditorit Gjeneral (ZAGJ) në Kosovë. Sipas nenit 3.2 të kësaj rregulloreje, nga Auditori Gjeneral (AGJ) kërkohet të kryej auditimin e rregullt vjetor të të gjitha institucioneve të Kosovës, duke përfshirë:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pasqyrë të vërtetë dhe të drejtë;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Përkatësinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm;
- Ndershmërinë dhe drejtësinë e vendimeve administrative të zbatuara në kuadër të institucionit ose të entitetit që iu është nënshtruar auditimit; si dhe
- Të gjitha çështjet të cilat dalin ose kanë të bëjnë me auditimin;

Në muajin mars të vitit 2003, Kuvendi i Kosovës e ka nxjerr Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë nr. 2003/2 (LMFPP), i cili ligj edhe formalisht është shpallur nga PSSP- me Rregulloren nr 2003/17 të datës 12 maj 2003.

1.2 Fushëveprimi i auditimit

Objektiva primare e këtij auditimi është që t'i mundësohet ZAGJ-së që ta japë opinionin nëse pasqyrat financiare të Zyres se Kryeministrit japin një pasqyrë të vërtetë dhe të drejtë për shpenzimet e kryera gjatë vitit i cili ka përfunduar më 31 dhjetor 2006, si dhe nëse janë përgatitur në pajtim me Standardet ndërkombëtare të kontabilitetit të sektorit publik (SNKSP) lidhur me "raportimin financiar sipas kontabilitetit të parasë së gatshme". SNKSP-të janë nxjerr nga Bordi i standardeve ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik (BSNASP) të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (FNK).

1.3 Standardet ndërkombëtare të auditimit (SNA)

Pasqyrat financiare të Zyres se Kryeministrit për vitin 2006 kanë qenë subjekt i auditimit të pavarur i cili është realizuar në pajtim me SNA-të . Këto standarde e përcaktojnë kornizën ndërkombëtare sipas së cilës Zyra e Auditorit të Përgjithshëm duhet t'i kryejë detyrat dhe t'i përfshijë çështjet siç janë, parimet dhe përgjegjësitë e përgjithshme, vlerësimi i rrezikut dhe përgjigjet ndaj rreziqeve të vlerësuara, dëshmitë e auditimit, mbështetja në punë e të tjerëve dhe konkluzionet si dhe raportimi i auditimit.

1.4 Çështjet që ndikojnë në dhënien e opinionit

Ne nuk kemi qenë gjendje të krijojmë siguri të mjaftueshme se Pasqyrat Financiare të Zyrës se Kryeministrit të prezantuara për vitin 2006 ,e prezantojnë drejtë dhe saktë gjendjen reale .

Për këto arsye

- Mos funksionimi adekuat i kontrollit të brendshëm.
- Procedurat e shpenzimeve nuk kanë qenë në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi.
- Mos respektimi i rregulloreve dhe procedurave sa i përket menaxhimit të pasurisë, ka ndikuar në mos prezantimin e gjendjes reale të pasurisë në Pasqyra Financiare.

1.5 Opinioni Auditimit

Duke u bazuar në çështjet të cilat ndikojnë në dhënien e opinionit, kemi ardhur në përfundim se pasqyrat financiare të Zyrës se Kryeministrit për vitin 2006 nuk e prezantojnë gjendjen reale .

Prandaj japim opinion të kundërt për Pasqyrat Financiare të Zyrës se Kryeministrit për vitin 2006.

1.6. Struktura e këtij raporti

Hyrja në Kaptinën 1 përcillet me kapitujt në vijim duke mbuluar çështjet në vijim:

- Kaptina 2 Raportimi i të dhënave financiare
- Kaptina 3 Të Hyrat
- Kaptina 4 Shpenzimet
- Kaptina 5 Menaxhimi i asetëve

Të gjeturat e hollësishme të auditimit të përfshira në raport janë ilustrime të çështjeve kyçe që janë gjetur gjatë auditimit të Zyrës së Kryeministrit të Kosovës, por që nuk duhet të merren se mund t'i shpalosin të gjitha çështjet e gjetura gjatë procesit të auditimit.

2. Raportimi i të dhënave financiare

2.1. Pasqyrat Financiare

Me procedura analitike është bërë krahasimi i pasqyrave financiare të entiteti me librin kryesor, krahasimi i pasqyrave financiare të vitit aktual me vitin paraprak, si dhe krahasimi me shumën e buxhetuar me shumave të realizuara.

Të hyrat dhe shpenzimet e ZKM për vitin 2006 janë prezantuar në tabelën më poshtë:

Tabela 1: Të hyrat dhe shpenzimet

	Alokimet nga fondi i BKK- së	Donacionet	Totali
	€	€	€
Të hyrat:	4,030,972	793,076	4,824,048
Shpenzimet:			
Pagat dhe mëditjet	571,861	22,522	594,384
Mallrat dhe shërbimet	2,136,741	316,917	2,453,659
Shpenzimet komunale	139,965		139,965
Subvencionet dhe Transferet	349,326	70,000	419,326
Shpenzimet kapitale	223,488		223,488
Shpenzimet totale	3,421,381	409,439	3,830,822
Bilanci i të hyrave të pashpenzuara	609,590	383,636	993,226

- Pasqyrat Financiare janë përgatitur sipas Udhëzimit Administrativ 2006/10
- Burimet e te hyrave për Zyrën e Kryeministrit janë nga Buxheti i Kosovës dhe nga Donatorët e ndryshëm si DIFID, SIDA dhe PTK
- Në bazë të Vendimeve të Qeverisë është bërë financimi i disa projekteve dhe subvencioneve për të cilat është lejuar buxheti me vonë.

2.2. Sistemi i Kontrollit të Brendshëm

E Gjetura 1

Ndarja e detyrave si segment i kontrollit të brendshëm nuk është bërë në mënyrë adekuate, sa i përket procedurave të prokurimit. Në shumicën e rasteve të përfshira në mostër menaxheri i prokurimit ka marr pjesë në komisionin e vlerësimit dhe ka miratuar raportin e vlerësimit në kundërshtim me bazën ligjore. Po ashtu zyra e prokurimit nuk ka staf të kompletuar.

Ndikimi

Funksionimi i dobët i kontrollit të brendshëm krijon parakushte për përzije kompetencash dhe përgjegjësish si dhe mos arritjen e objektivave të caktuara .

Rekomandimi

Entiteti duhet të forcoj strukturën e kontrollit të brendshëm në mënyrë që të siguroj një siguri të mjaftueshme që objektivat përkatës do të arrihen.

E Gjetura 2

Gjatë vitit 2006 nuk ka funksionuar departamenti i auditimit të brendshëm dhe asnjë person nuk ka qenë i caktuar në funksionin e auditorit të brendshëm. Prandaj nuk ekziston ndonjë raport i auditimit të brendshëm.

Por në vërejtje se është bërë angazhimi i një auditori të brendshëm që nga Janari i vitit 2007.

Ndikimi

Mos funksionimi i auditimit të brendshëm sjellë efekte negative për menaxhmentin sepse nuk mund të siguroj informacion mbi efikasitetin dhe efektivitetin e ekzekutivit ,dhe besueshmërinë e raportimeve financiare , zbatimin e ligjeve dhe vendimeve.

Rekomandimi

Funksionimi i auditorit të brendshëm i mundëson menaxhmentit të siguroj informacione sa i përket efikasitetit dhe efektivitetit të veprimtarisë së menaxhmentit si dhe besueshmërinë e pasqyrave financiare dhe zbatimin rregulloreve dhe ligjeve .

3. Të hyrat

Organizata nuk ka të hyra vetanake për vitin 2006.

4. Shpenzimet

4.1. Pagat dhe mëditjet

Përmbledhja e shpenzimeve për paga sipas departamenteve është prezantuar në tabelën e mëposhtme:

Tabela 2: Pagat dhe Mëditjet

	Zyra e Kryeministrisë	Kabineti Krye-Ministrit	Strategjia për zhvillim ekonomik	Agjencia për Integritet Evropiane	Zyra për Çështje Gjinore	Totali
	€	€	€	€	€	€
Pagat neto	325,320	146,888	19,536	12,093	7,473	511,310
Taksa	10,609	14,057	1,412	533	423	27,034
Kontributi i punëtorëve	17,680	8,470	787	664	415	28,016
Kontributi i punëdhënësit	17,680	8,470	787	664	415	28,016
Totali	371,289	177,885	22,522	13,954	8,726	594,376

4.1.1. Lista e pagave

Të gjeturat

Gjate ekzaminimit të listave të pagave kemi vërejtur se një numër i madhe i të punësuarve nuk kanë nënshkruar listën e pagave gjate tërë vitit.

Ndikimi

Sipas opinionit tonë mos nënshkrimi i listës së pagave mund të rrisë rrezikun që personat të cilët nuk punojnë në organizatë mund të paguhen.

Rekomandimi

Rekomandojmë që të gjithë personat të cilët gjinden ne listat e pagave duhet te nënshkruhen .

4.1.2. Dosja e personelit

Të gjeturat

Gjatë ekzaminimit të dosjes së personelit ne kemi vërejtur çështjet në vijim:

- Kriteret në shpalljen e vendit të punës nuk janë respektuar,
- Kontratat janë nënshkruar pa u përfillur dispozitat e Rregullores për Shërbimin Civil të Kosovës dhe akteve tjera nen-ligjore për zbatimin e saj,
- Personat me afat të skaduar të kontratës nuk janë larguar nga lista e pagave.¹

Ndikimi

Dështimi për të respektuar kriteret në konkurs mund te shkaktoj eliminimin e kandidatëve të mirë dhe profesional .Nënshkrimi i kontratave pa konkurs është shkelje te dispozitave ligjore Shërbimit Civil sepse shkakton diskriminimin e shume kandidateve potencial . Mos largimi i personave nga lista e pagave të cilëve u ka skaduar kontrata e dëmton buxhetin e Kosovës .

Rekomandimi

Qe te respektohen kriteret e konkursit për te gjithë aplikuesit duke respektuar Udhëzimin Administrativ Nr MSHP/DASHC 2003/01. Te mos nënshkruhen kontrata pune pa u respektuar te gjitha procedurat dhe kriteret paraprake .Te gjithë personat me kontrata të skaduar duhet të largohen nga lista e pagave në pajtim me Udhëzimin Administrativ Nr. MSHP/DASHC 2003/02.

¹ Ne kemi kuptuar që ish- Sekretari Permanent vazhdon të marr pagën e tij edhe pas shkarkimit nga pozita e Sekretarit Permanent.

4.2. Subvencionet dhe transferet

Tabela 3: subvencionet dhe transferet

	Zyra e Kryeministrisë	Kabineti Krye- Ministrit	Fondi për Media	Totali për 2006
	€	€	€	€
Subvencioni	14,700	10,000	49,999	74,699
Subvencioni për entitetet publike	70,000			70,000
Shërbimet e Telekomunikimit		3,000		3,000
Pagesa e familjeve viktime të luftës	271,626			271,626
Totali	356,326	13,000	49,999	419,325

- Pagesa për familje të viktimeve të luftës dhe për sjelljen e personave të zhdukur. Të gjitha pagesat kanë qenë në shumë të vogla dhe shumë persona kanë përfituar nga kjo ndihmë,
- Përkrahje mediave për minoritetet,
- Ndërtimin e 12 shtëpive për veteranet e ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

4.3. Mallrat dhe shërbimet dhe shpenzimet kapitale

4.3.1. Zotimi i mjeteve

Të gjeturat

Me rastin e ekzaminimit të lëndëve të zgjedhura si mostër, kemi vërejtur se entiteti ka hyre në obligime me operatorët ekonomik pa zotim të mjeteve. Të lartë përmendurat janë gjetur në kontrata vijuese:

- Blerja e telefonave mobil në vlerë prej 6,815 Euro me UOP në bazë të referencës 00226,
- Blerja e pajisjeve TV,DVD në vlerë 4,013 Euro me UOP në bazë të referencës 00305,
- Blerja e veturave në vlerë 13,875 Euro me UOP në bazë të referencës 00461,
- Blerja e Mobileve në vlerë 9,258 Euro me UOP në bazë të referencës 00272,
- Blerja e Pajisjeve teknologjike në vlerë prej 36,181 Euro me UOP në bazë të referencës 00470.
- Organizimi i workshopeve në vlerë 43,382 Euro me UOP në bazë të referencës 0044.

Ndikimi

Hyrja e entitetit në obligime pa zotimin e mjeteve përmban në vete një rrezik se obligimet nuk mund të kryhen në të ardhmen, mund të krijohen shpenzime të cilat nuk mund të mbulohen. Veprimet si të tilla konsiderohen si të paligjshme dhe të palejueshme.

Rekomandime

I rekomandojmë Zyrës së Kryeministrit që ti përmbahet Nenit 8.2 të Ligjit të Prokurimit mbi disponueshmërinë e mjeteve .

4.3.2. Planifikimi i prokurimit

Të gjeturat

Gjatë ekzaminimit të disa lendeve kemi vërejtur se disa lende nuk kanë qene të përfshira në planin e prokurimit

- Blerja e TV dhe DVD ,Kontrata për blerjen e TV,DVD /VCR,antena për TV,ne baze të UOP 00305
- Rrethimi i objektit në Zyrën e Kryeministrit në baze të UOP me Nr referencës 00097
- Shërbime të ndryshme në objektin e Qeverisë në baze të UOP me nr reference 00271
- Blerja e mallrave dhe shërbimeve të fushës së sigurisë dhe kontrolluese në baze të UOP me Nr reference 00167.
- Furnizim me mallra të TI në baze të UOP me numër reference 00470

Ndikimi

Planifikimi jo adekuat i aktiviteteve të prokurimit mund të ndikojë në mos arritjen e objektivëve përkatës dhe qëllimin e entitetit.

Rekomandimi

Auditorët i rekomandojmë entitetit në të ardhmen të ketë një planifikim në detale dhe që blerjet e mallrave dhe kryerjet e shërbimeve të përputhen me planin e prokurimit.

4.3.3. Çështjet e ndërlidhura me dokumentet e ofertimit dhe çmimeve të ofruara

Të gjeturat

Me rastin e ekzaminimit të lëndës mirëmbajtja dhe riparimi i Aparateve Fotokopjuese(TI), me numër te referencës se UOP-se 00103 shihet ne dosjen e tenderit se ofertuesi ne disa artikuj ka ofruar çmime nën çdo nivel të parashikuar kështu në total ka ndikuar të jetë më i liri në krahasim me ofertat tjera. Mirëpo gjate gjithë periudhës sa e mbulon kontrata Entiteti nuk është furnizuar me këta artikuj.

Ndikimi

Mendojmë se një veprim i tillë do te ndikoj që disa artikuj më të domosdoshëm për entitetin te jenë në nivel më të lartë të çmimeve ndërsa disa me pak te domosdoshëm te kenë çmime shumë të ulëta .

Rekomandimi

Auditorët rekomandojnë entitetin qe në rastin e ofrimit të ofertave te tilla të jenë më të kujdesshëm ndaj një veprimi të tille te ofertuesve. Në të ardhmen duhet të refuzoni një veprim të tillë.

4.3.4. Raportet për pranimin e mallrave dhe shërbimeve

Të gjeturat

Ne disa lëndë mungon raporti i pranimit te mallrave dhe shërbimeve

- Blerja e automjeteve nga UNMIK ne vlere 13,876 Euro me UOP ne baze te referencës 00461
- Blerje e TV dhe DVD ne vlere 4,013 Euro me UOP ne baze te referencës 00305
- Kryerja e punëve ne objekt dhe jashtë objektit te qeveris,ne vlere 17263 Euro ne baze me UOP ne baze te referencës 00271.
- Furnizim me pajisje te TI ne vlere 36,181 Euro me UOP ne baze te referencës 00470
- Organizimi i workshopeve ne vlere 43,382 Euro me UOP ne baze te referencës 0044.
- Organizimi i workshopeve ne vlere 30,000 Euro me UOP ne baze te referencës 0034.

Ndikimi

Mund të pranohen mallrat të cilat nuk i përmbushin kërkesat e kontraktuara dhe kriteret për shkak të mungesës së raporteve mbi pranimin e mallit. Gjithashtu, është një mundësi që mallrat mund të mos jenë pranuar apo janë pranuar por nuk janë shfrytëzuar për përfitim të organizatës por për qëllime private.

Vëmendje të posaçme duhet t'i kushtohet mallrave të blera pa zotim paraprak të mjeteve (pika 5.3.1) e cila po ashtu është paraqitur në këtë të gjetur.

Rekomandimi

I rekomandojmë entitetit që me rastin e pranimit të mallrave dhe shërbimeve të caktuara të ketë raporte pranimi dhe pranimit të bëhet me komisione të caktuara në mënyrë që kualiteti i shërbimeve dhe mallrave të jetë në përputhje me specifikat e kërkuara.

4.3.5. Shpenzimet për riparimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve

Të gjeturat

Në disa raste kemi vërejtur mos pajtueshmëri në mes çmimit të ofertës dhe çmimit të faturuar.

- Shpenzime të riparimit për automjetin Skoda Fabia me targa numër 000-KS-128
- Shpenzime të riparimit për automjetin Skoda Fabia me targa numër 000-KS-141
- Shpenzimet për ndërrimin e pjesëve rezervë dhe rrotave të automjetit Mercedes me targa 000-KS-003

Ndikimi

Jo harmonizimi midis çmimit të ofertës dhe çmimit të faturës mund të shkaktojë shpenzime të papritura për entitetin, gjë që mund të dëmtojë BKK.

Rekomandimi

Rekomandojmë entitetin që gjatë riparimit të automjeteve të rishikojnë çmimin në oferte në mënyrë që të mos ketë ndryshime midis çmimeve.

4.3.6. Furnizim me pajisje të TI

E gjetura

Në lenden, furnizim me pajisje të TI në vlerë prej 52,087 Euro dhe numër të UPO-se 00489, 00488, 00486 kemi konstatuar se janë shpërblyer tri kompani edhe pse në bazë të dosjes së tenderit furnizimi nuk ka qenë i ndarë në Lote.

Ndikimi

Një veprim i tillë mund të shkaktojë konkurrence të padrejtte dhe dështim në respektimin e kriterëve të parapara në dosjen e tenderit.

Rekomandimi

Rekomandojmë entitetin që t'i respektoj kriteret që parasheh dosja e tenderit.

4.3.7. Organizimi i workshop-ve

Të gjeturat

Lënda “organizimi i Workshop-ve” në vlerë prej 43,382 Euro është tenderuar në dy Lote. Gjate procesit të vlerësimit komisioni nuk ka proceduar ashtu sic është tenderuar, por ka ndarë tenderin në 7 lënde. Edhe pse Oda Ekonomike e Kosovës ka qenë më e lira nga të gjitha ofertat e përgjegjshme, ajo është shpërblyer vetëm për dy lende. Kompania FID ka qenë fituese për lëndën “Arsimim dhe trajnim” në vlerë prej 14, 714 Euro edhe pse po për këtë lëndë Oda Ekonomike e Kosovës ka ofruar çmimin 8, 625 Euro pra diferenca është 6, 089 Euro. Kompania MDA ka qenë fituese për lëndën “Zhdukja e varfërisë” në vlerë prej 10, 843 Euro, ndërsa për lëndën e njëjtë Oda Ekonomike e Kosovës ka ofruar çmimin 9, 200 Euro me një diferencë prej 1, 643 Euro. Një lëndë është organizuar nga Strategjia për zhvillim ekonomik që është sektor brenda Zyrës së Kryeministrit. Dy lëndë të tjera nuk janë organizuar fare.

Ka qenë edhe një lëndë tjetër “Organizimi i workshopve” për të cilën nuk ka pasur ofertë të përgjegjshme.

Ndikimi

Mendojmë që entiteti në lëndën “Organizimi i workshopeve” ka krijuar shpenzime të panevojshme, meqë Oda Ekonomike e Kosovës për lëndën e njëjtë ka konkurruar me çmim më të lirë dhe gjithashtu ka plotësuar kriteret e kërkuara në dosjen e tenderit. Në bazë të nenit 30.3 të LPP 2003/17 në rastet kur janë më pak se tri oferta të përgjegjshme tenderi duhet të anulohet.

Rekomandim

Rekomandojmë entitetin që kur kompania plotëson kriteret e kërkuara në dosjen e tenderit, të marrin parasysh çmimin më të lirë.

Rekomandojmë entitetin të veprojë në përputhje me nenin 30.3 të LPP 2003/17 për rastet kur nuk janë tri oferta të përgjegjshme.

4.3.8. Furnizim me orendi për zyre

Të gjeturat

Me 27.01.2006 entiteti ka marr aprovimin nga APP qe te përdor procedurën e negociuar për furnizim me mobilie për zyre ne vlere 15,000 Euro. Edhe pse furnizimi ka tejkaluar vlerën e lartpërmendur, ata nuk kanë përdorur procedura te rregullta, por gjate vitit 2006 janë furnizuar në vlerë prej 50,402 Euro.

Ndikimi

Një veprim i tillë mund të shkaktojë eliminimin e konkurrenteve te tjerë dhe njëkohësisht paraqet shkelje të Ligjit te Prokurimit Publik 2003/17.

Rekomandimi

Rekomandojmë entitetin të veproje në përputhje me nenin 30 te LPP 2003/17.

4.3.9 Harmonizimi i shpenzimeve

Të Gjeturat

Tabela në vijim prezanton shpenzimet e karburanteve dhe mirembajtjs së automjeteve sipas të dhënave të entitetit dhe të dhënave në Thesar:

Përshkrimi i shpenzimeve	Te prezantuar nga Pasqyrat Financiare të Thesarit (viti 2006)	Te prezantuar nga zyra për menaxhimin e automjeteve (ZMA) (viti 2006)	Obligimet e paguara prej vitit 2005 ne vitin 2006	Diferenca mes te Pasqyrave Financiare dhe ZMA
	€	€	€	€
Shpenzimet e karburanteve	117,297.40	92,919.05	22,307.07	2,071.28
Shpenzimet e servisimit	173,258.61	100,517.48	17,169.60	55,571.53
Totali	290,556.01	193,436.53	39,476.67	57,642.81

Nga tabela me lart mund te shohim shpenzimet e paraqitura nga Pasqyrat Financiare nuk përputhen me te dhënat e prezantuara nga Zyra për Menaxhimin e Automjeteve për 57,643 € .

Sipas specifikacionit për kilometrat e kalkuluar nga Zyra për Menaxhimin e Automjeteve për periudhën janar – nëntor / 2006 kemi 288,639 kilometra te kaluara. Nëse e llogarisim me një mesatare 10 km / 1.2 litër karburante atëherë kemi 34637 litra karburante te shpenzuara. Mesatarja e çmimit për karburante është 0.915 (0.90 për nafte dhe 0.93 për benzinë). Nëse e llogarisim ne vlere $34637 * 0.915 = 31693$.

Ndikimi

Mungesa e një specifikacioni te sakte për shpenzimet e servisimit dhe karburanteve paraqet vështirësi ne menaxhimin e automjeteve .

Rekomandim

I rekomandojmë zyrës për menaxhimin e automjeteve qe te paraqes një pasqyre sa më të saktë të shpenzimeve sa u përket automjeteve.

Te mbaje një evidence te sakte për regjistrimin e shpenzimeve te servisimit, dhe te përputhen te dhënat e prezantuara nga Zyra e Menaxhimit te Automjeteve me ato te prezantuara ne Pasqyrat Financiare.

Te mbaje një specifikacion për kilometrat e kaluara për secilin automjet, dhe te mbaje një evidence te shpenzimeve te karburanteve ne raport me kilometrat e kaluara ne baze te një normativi te caktuar.

5. Menaxhimi i aseteve

5.1. Regjistrimi i aseteve dhe inventarizimi

Të gjeturat

Ne baze te ekzaminimit te disa lëndëve kemi vërejtur se disa mjete themelore dhe inventar te blera gjatë vitit 2006 nuk figurojnë në Fletëregjistrimin e Mjeteve Themelore dhe Inventarit

Laptopi HP COMPAQ 4200 P.M 750 121512/60 (PV984AW) dhe NOTEBOOK FUITSU SIEMENS AMILO PRO V2065 PART APED 206561/1EE .Edhe gjate ekzaminimit fizik nuk kemi mundur te sigurojmë dëshmi për Laptopet e larte përmendur .

Po ashtu gjate ekzaminimit te disa lendeve shihet se vlere e për disa mjete themelore dhe inventar nuk korrespondon ne mes librave kontabël dhe Flete regjistrimit të Mjeteve Themelore dhe Inventarit.

Gjate vitit 2006 nuk është bere zhvlerësimi i pasurisë .

Ndikimi

Mos evidentimi i gjithë pasurisë ne Fletëregjistrimin e mjeteve themelor dhe inventarit krijon parakushte për shmangien e mjeteve themelore .

Vlerësimi jo i drejte i pasurisë do ndikoj qe entiteti ne pasqyra te mos e paraqes gjendjen reale te mjeteve themelore dhe inventarit .Mos aplikimi i zhvlerësimit te pasurisë paraqet vështirësi ne përcaktimi e vlerës se drejte te pasurisë .

Rekomandimet

Rekomandoj entitetit qe ne fletëregjistrimin e mjeteve themelor dhe inventarit te evidentohen te gjitha mjete themelore dhe inventari .

Po ashtu te gjitha pasurit duhet te paraqitën sipas vlerës kontabël dhe duhet te behet zhvlerësimi i pasurisë.

Rekomandoj entitetin qe ti përmbahet Instruksionit Administrativ 2005/11

5.2. Shfrytëzimi i automjeteve

Të Gjeturat

Gjate ekzaminimit te lendeve kemi vejtur se nuk ekzistojnë procedura për shfrytëzimin e automjeteve .Sektori i logjistikes nuk ka kontroll mbi automjete , vetëm ne raste ne ndonjë defekti teknik dërgon automjete ne servisim. Secili departament përkujdeset për shfrytëzimin e automjeteve .

Gjate ekzaminimit te lendeve neper departamente kemi vërejtur se automjete shfrytëzohen pa destinim dhe qellim te caktuar.

Shfrytëzimi i automjeteve jashtë orarit te punës behet pa aprovime përkatëse.

Ndikimi

Mos aplikimi i kontrollit nga sektori i logjistikes, shfrytëzimi i automjeteve pa destinim dhe qellim te caktuar do te ketë ndikim ne shfrytëzimin jo efikas te automjeteve.

Rekomandimet

Rekomandojmë qe sektori i logjistikes te ketë një kontroll mbi automjet ,dhe njëkohësisht për çdo shfrytëzim te automjeteve duhet të ketë një destinim dhe qëllim të caktuar.

Po ashtu e rekomandoj entiteti te përmbahet Udhëzimit administrativ Nr 2006/07 për përdorimin e automjeteve të qeveris së Kosovës .

5.3. Mirëmbajtja e automjeteve

Të Gjeturat

Automjeti NISSAN me targa 000-KS-071 i aksidentuar me datën 07.06.2006 ne ora 21.00 ,nga ekzaminimi i lendes nuk kemi hasur ne ndonjë raporte aksidenti te lëshuar nga policia , njëherazi nuk kemi vërejtur raporti mbi destinimin dhe qëllimin e udhëtimit .

Me rastin riparimit te automjetit te aksidentuar kemi vërejtur pozicione te faturuar qe nuk ekzistojnë ne oferte

Automjeti MICUBISHI POJERA me targa 000-KS-062 i aksidentuar me datën 31.12.2005 nga ekzaminimi i lendes shihet se personi i autorizuar për vozitjen e automjetit nuk ka qene duke e vozitur me rastin e aksidentit .

Me rastin riparimit te automjetit te aksidentuar kemi vërejtur pozicione te faturuar qe nuk ekzistojnë ne oferte .

Automjeti Daimlerchrysler me targa 000-KS-030 e cila është aksidentuar me date 20.07.2006 sipas raportit te Zyrës se Menaxhimit te Automjeteve, nuk është argumentuar aksidenti me raportin e policisë mbi aksidentimin. Riparimi i automjetit është bere tek kompania e cila nuk kanë pasur kontrate për riparimin dhe mirëmbajtjen e këtij lloji te automjetit.

Automjet Mitsubishi Pajero me targa 000 – KS – 060, për vitin 2006 Zyra për menaxhimin e Automjeteve ka regjistruar shpenzime te servisimit ne vlere prej 22,138, ndërsa sipas faturave ne dosjen e automjetit kemi shpenzime për 5,133 , me një diference prej 17,005. Për këtë automjet nuk ka pasur aksidente gjate vitit 2006.

Automjeti Mercedes Benz me targa 000 – KS – 003, për vitin 2006 janë bere shpenzime te servisimit për 24,629 sipas faturave. Zyra për menaxhimin e Automjeteve ka regjistruar si shpenzime te servisimit për këtë automjet 13,981, me një diference prej 10,648. Gjate vitit 2006 nuk ka pasur aksident ky automjet.

Ndikimi

Shfrytëzimi i automjeteve pa autorizime përkatëse dhe pa destinim e qëllim te caktuar do te ndikoj ne përdorimin jo racional te automjeteve dhe do te ndikoj ne shpenzimin e buxhetit te entitetit ne mënyre jo efikase,po ashtu faturimi i disa pozicioneve te cilat nuk ekzistojnë ne oferte respektivisht ne kontratë me rastin e riparimit te automjeteve do te ketë efekte negative për entitetin .

Gjithashtu, është një dyshim serioz në lidhje me legjitimitetin e të gjitha aksidenteve dhe riparimeve të përshkruara më lart.

Rekomandimet

Rekomandojmë që shfrytëzimi i automjeteve të bëhet në mënyrë sa më racionale të dihet qëllimi dhe destinimi për çka shfrytëzohet secili automjet.

Po ashtu rekomandojmë entitetit të shpallë tender të ri për servisimin e automjeteve dhe të ketë një specifikacion teknik me gjithë përfshirës sepse mungojnë disa pozicione në ofertat e kompanive që i mirëmbajnë dhe i riparojnë automjetet.

Komentet nga Zyra e Kryeministrisë

Zyrës së Kryeministrit (ZKM) i është dhënë mundësia për komentet në raportin e auditimit të Pasqyrave Financiare të ZKM-së për vitin 2006 në mënyrë të eliminimit të rrezikut të keqinterpretimit dhe keqkuptimit në mes auditorëve dhe entitetit të audituar.

ZKM në përgjithësi pranon konkludimet dhe rekomandimet e auditorëve përveç disa pikave.

Komentet nga ZKM nuk kanë qar në ndryshime në këtë pjesë të raportit final të Pasqyrave financiare të ZKM-së për 2006.

Për të siguruar transparencën në proces ne i kemi bashkangjitur komentet nga ZKM-ja si aneks në Raportin final të auditimit të pasqyrave financiare të ZKM-se për vitin 2006 .

Duke marrë parasysh të dhënat shtesë që ju prezantuat tek ne, ne rishikuar të gjeturat tona . Sidoqoftë, ne do të çmojmë nëse në të ardhmen ju siguron dosjet complete gjatë punës tonë të auditimit në terren.

Ne i çmojmë komentet e juaja por ne prapë qëndrojmë pas opinionit tonë.

Ne gjithashtu dëshirojmë të falënderojmë stafin e ZKM-së për një komunikim dhe bashkëpunim të mirë gjatë procesit të auditimit .

KOMENTET E ZYRES SE KRYEMINISTRIT DHE ZYRES SE AUDITORIT		
	Komentet e Zyres se Kryeministrit	Përgjigjet e auditorit
1.	Pika 1.1.Opinionit ne auditim	
	<p>1. Evidenca Kontabel – raportet financiare, sipas rregullave te tanishme, te BKK mbahet ne baze te sistemit te parase se gatshme dmth. pasqyrat financiare permbajne te gjitha pagesat-shpenzimet buxhetore te realizuara ne kete periudhe prej dates 01.01. deri 31.12.2006 pa marre parasysh ne cilin vit jane krijuar ate obligime.</p> <p>2. Pasqyrat financiare jane hartuar ne perputhshmeri te plote me rregulloren e MEF-itThesarit nr 2006/14 dhe paraqesin gjendjen reale te te gjitha shpenzimeve (pagesave) per vitin 2006.</p> <p>3.Te gjitha te dhenat ne pasqyra financiare jane te harmonizuar me raportet e pagesave te Thesarit dhe ate si te hyrat po ashtu edhe shpenzimet.</p> <p>4. Duhet te cekni cilat pozicione te pasqyrave Financiare nuk jane reale</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kodi buxhetor, - Kodi Buxhetor - Kodi Ekonomik - Te Hyrat nga BBK - Te Hyrat nga Donacionet - Shpenzimet e tjera. 	<p>Pika 1.1. Opinionit ne auditim</p> <p>1.2.3.4. Ne raport e kemi ceke perse është dhënë një opinion i kundërt arsyet për këtë janë sepse janë shkelur Ligji i prokurimit publik , ligji mbi menaxhimin e financave publike , Instruksionin Administrativ nr. 2005/11 mbi menaxhimin e asetëve , si dhe mjetet themelore nuk janë paraqitur ne mënyre te drejte. E gjetura mbetet</p>
2.	5. Menaxhimi i asetëve	
	5. Regjistrimi fizik i asetëve është bere ne menyre te rregullt nga	5. Mjetet e blera nga viti 1999 duhet

	komisionet perkatëse. Programi i mbajtjes së evidencës 512 pasurisë nga ana e MEF-it është aplikuar nga fillimi i vitit 2006. Mirëpo në momentin e futjes 512 asetëve në program, në baze të inventarizimit janë futur edhe mjetet që nga viti 1999, për të cilat nuk kanë mundur të gjenden dokumentacion, prandaj janë marrë si vlera mesatare	te kenë mbështetje në fatura dhe dokumente përkatëse , Ndërsa vlerësimi i mjeteve themelore me vlerë mesatare është bërë pa ndonjë vendim të caktuar. E gjetura mbetet
3.	Pika 4.3.1 Zotimi i mjeteve	
	6.Zotimi i mjeteve është bërë në mënyrë të rregullt duke u harmonizuar me mundësitë buxhetore gjegjësisht me pasqyrën e rrjedhës së parase, ka pasur raste urgjente për të cilat nuk ka pasur mundësi zotimi duke marrë parasysh nevojat urgjente të furnizimit	6. Edhe në raste urgjente duhet të bëhet zotimi i mjeteve para fillimit të aktivitetit të prokurimit. E gjetura mbetet
4.	Pika 4.3.9 Harmonizimi i shpenzimeve	
	7. Nga viti 2005 janë bartur si obligime të pa paguara në vitin 2006, vlera prej 251.694.49 euro, të cilat janë paraqitur në pasqyra financiare si obligime të bartura për vitin 2006. Prandaj, këto shpenzime nuk i kanë të evidentuara për vitin 2006, njësitë përkatëse gjegjësisht ZMA, sepse ato janë të regjistruara me komision si obligime të pa paguara dhe janë dorëzuar për pagesë,	7. Sa i përket harmonizimit të shpenzimeve në i kemi marrë në konsideratë edhe obligimet e pa paguara nga viti 2005 por edhe obligimet e bartura në vitin 2006 ku të gjitha të dhënat i kemi paraqitur në tabele – harmonizimi i shpenzimeve në raport. E gjetura mbetet
5.	Pika 5.1 Regjistrimi asetëve	
	8. Zhvlerësimi asetëve duhet të bëhet në harmoni me programin e aplikuar nga ana e thesarit , i cili tani për tani nuk mundëson zhvlerësimin e asetëve .mirëpo	8..Zhvlerësimi i asetëve do të ketë efekte pozitive për entitetin edhe

	ne kemi pasur ndonjë shitje të aseteve e cila kishte me pasur ndikim në ndonjë humbje të pasurisë në të kundërtën do të bënim zhvlerësimin në baze të standardeve të kontabilitetit mbi Zhvlerësimin e aseteve	nëse këtë nuk e ka mundur thesari. E gjetura mbetet
6.	Pika 4.1.1 Lista e pagave	
	9. Eshtë e vertet se një numër i konsideruar i të punësuarve në Zyren e Kryeministrit nuk e kanë nënshkruar listën e pagave për çdo muaj, mirepo garantojmë se në listën e pagave nuk ka persona që nuk punojnë në Zyren e Kryeministrit. Sigurojmë se tash e tutje të gjithë zyrtarët do të nënshkruajnë listën e pagave për çdo muaj.	9. Mos nënshkrimi i listave të pagave rrit dyshimin e vijimësisë në punë dhe mos funksionim i sistemit të kontrollit të brendshëm lidhur me të punësuarit brenda zyrës. E gjetura mbetet
7.	Pika 4.1.2. Dosja e personelit	
	<p>1. Konsiderojmë se Komisioni për përzgjedhjen e kandidatëve ka respektuar kushtet e konkursit. Nëse një kandidat ka pasur shumëtribute pozitive dhe nëse i ka munguar përvoja e kërkuar për shkak se një vend i tillë i punës nuk ka ekzistuar dhe nuk ka mundur të krijohet një përvojë e tillë, komisioni ka vlerësuar se ai duhet të punësohet kandidati me i pershtatshëm për atë post. Një rast të tillë e kemi pasur</p> <p>2. Nuk ka asnjë kontratë të nënshkruar pa u përfillur procedurat e Ligjit mbi Sherbimin Civil. Përjashtime ka pasur në raste kur është kërkuar plotësimi i vendeve të punës me urgjencë për shkak të shtimit të vëllimit të punëve dhe detyrave të punës për vendet e caktuara në zyrë të caktuara. Kjo ka ndodhur tek Agjencioni për Integrim Evropian ku janë angazhuar punëtorë - praktikantë me kontratë të perkohshme për kryerjen e punëve dhe detyrave të punës deri në shpalljen e konkursit publik.</p> <p>3. Pajtohem që ish Sekretari i Përhershëm i ZKM-se ka qenë në listën e pagave deri në fund vitin e 2006, dhe se për këtë ekziston vendimi nr. 19 /2006 datë 21 prill 2006 të nxjerr nga Komisioni për Emërime të larta</p>	<p>1. Komisioni për përzgjedhjen e kandidatëve se pari duhet të përmbahet kriteret e konkursit e pastajtributeve pozitive .</p> <p>2 .Edhe në qoftë se paraqiten urgjencë dhe shtim i vëllimit të punëve duhet të respektuar ligjet dhe rregulloret në fuqi dhe duhet kaluar nëpër procedurat e kërkuara .</p> <p>3. Çdo të punësuar si shërbyes civil në qoftë se i ndërpritet kontratë duhet të largohet nga sistemi I pagave .</p> <p>Te gjeturat mbeten</p>

	Publike ne te cilin thuhet se z. Mehmet Hajrizi mos ti ndërpritet paga derisa ti ofrohet vendi i ri i punës. Nga momenti kur nga Sekretaria e KELP-it kemi marre informatën se ish Sekretari i Përhershëm mund te largohet nga Lista e pagave, administrata menjëherë ka vepruar dhe personi ne fjale është larguar nga lista e pagave . (vendimi nr. 19/2006 i KELP).	
8.	Pika 4.3.4 Raporti i pranimit te mallrave dhe shërbimeve .	
	Sa i përket pikës se pare blerja e automjeteve nga UNMIK-u ne vlere prej 13,876,00 € ka një certifikate mbi pranim dorëzimin e automjeteve te blera ne te cilin mund te shihni nënshkrimet e anëtareve te komisionit nga ana e UNMIK-ut dhe personit -zyrtarit te Transportit nga ZKM-ja 02.10.2006. (certifikate e bashkëngjitur nr. ADU # 080/06 date 02.10.2006).	11. Raport i komisionit për pranimin e automjeteve nuk ekziston. E gjetura mbetet
9.	Pika 5 Menaxhimi asetëve	
	12. Sa i përket Laptopit HP COMPAQ 4200 P. M 750 121512/60 (PV984AE) dhe NOTEBOOK ka evidence se është tek njeri nga këshilltaret e Kryeministrit dhe ai është ne përdorim (dëshmi flete ngarkesa nr. 1204 date 22.08.2006, ne te cilën	Pika .5.Menaxhimi asetëve 12. Sa përket laptopit HP COMPAQ 4200 P M 750 121512/60 ,dhe

	<p>mund te shihni emrin e zyrtarit qe është ngarkuar me këtë laptop). Po ashtu ka evidence; se Laptop i nr. FUJITSU SIEMENS AMILO PRO V2065 PART:APED 206561/1EE i cili eshte ne perdorim tek ish Kryeministri Bajram Kosumi</p> <p>Pika 5.2 Shfrytzimi Automjeteve</p> <p>Pika 5.3 Mirmbajtja e Automjeteve</p>	<p>Laptop i nr FUJITSU SIEMENS AMILO PRO V2065 shihet se këta Laptops nuk janë te evidentuar ne listën e pasurisë , nuk figurojnë ne listën e regjistrimit te fund vitit , po ashtu edhe nga ekzaminimi fizik i kryer këta kane munguar .</p> <p>E gjetura mbetet</p>
10.	Komente shtese	
	<p>Pajtohemi me rekomandimet e auditoreve dhe sigurojme se duke filluar nga viti 2007 shfrytezimi i automjeteve po behet ne menyre racionale dhe perdorimi i automjeteve eshte duke u bere ne pajtim me UA nr. 7/2006 mbi perdorimin e Automjeteve te Qeverise se Kosoves. Kryesisht raporti ka paraqitur nje pasqyre relativisht objektive. Perkunder kohes se shkurter per nje analize me te detajizuar, ne raport kam hasur ne keto konstatime te cilat nuk qendrojne.</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Ekziston deshmia e zotimit te mjeteve per blerjen e veturave nga UNMIK-u perkunder konstatimit te Auditorit. 2. Ekziston deshmia e zotimit te mjeteve per organizimin e Workshopeve per nevojat e SPZHK-se. 3. Ekziston procesverbali i pranimit te sherbimeve nga "Nartel" lidhur me sherbimet e kryera brenda dhe jashte Objektivit te Qeverise. 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Me rastin e e blerjes se veturave te UNMIK-u zotimi i mjeteve është bere me datën 28.09.2006 kontrata me numër 3656 datës 26.09.2006. 2. Zotimi për organizimin e workshopeve i datës 22.11.2006 ne vlere 40.418 ndërsa kontrata me numër 06/0813 dhe 06/0814 me datën 07.11.2006. 3. Nuk ekziston ndonjë raport i pranimit për kryerjen e punimeve . <p>Sa i parkete vërejtjes se ligji i prokurimit nuk parasheh formimin e komisioneve për pranim te furnizimeve atëherë duhet te</p>

	Verejtjet se disa sherbime jane pranuar pa komision, konsideroj se nuk jane shkelje meqenese askund nuk parashihet ne LPP 2003/17.	shkojmë ne praktikat dhe standardet me te mira. Te gjeturat mbeten
--	--	---

